



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor - Ministry of Trade and Industry

UDHËZIMI ADMINISTRATIV Nr. _____

**PËR APLIKIMIN PËR KUSHTE TË NDËRTIMIT DHE LEJE NDËRTIMORE DHE
PËR LËSHIMIN E TYRE**

SHTOJCA Nr. 8

Mostra e Lejes Ndërtimore

Në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21 dhe Ligjit për Procedurën Administrative, Nr. 02/L-28, neni 11, neni 16 i Ligji për planifikim Hapsinor Nr. 04/L-174, neni 10 i Udhëzimit Administrativ të MMIPH-së Nr.06/2017 dt. 23.05.2017 për caktimin e procedurave për pregaditjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrenimi për kategorinë e I-re dhe të II-të të ndërtimeve, Vendimi për miratimin e hartave zonale nr. 02/600 të datës 06/11/2019. Kushtet ndërtimore nr. 05/764 dt. 19.12.2022 si dhe kërkesë së pales 08.02.2023 dhe dokumenteve të paraqitura nga pala, Drejtoria e Urbanizmit lëshon këtë.

Leje Ndërtimore

Kjo leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	FETAH JANUZ KRYEZIU / AGIMI SHPK		
Adresa:	Ruga "Ibrahim Mazreku" në MALISHEVË		
Telefoni:	044/529-898	Emaili:	Agimi-shpk.ks@hotmail.com

Emri projektit:	Objekt i kategorisë së II me destinim banim-afarizem me etazhitet B+P+8k.		
Emri projektusit:	" Studio Cena " SHPK , NR. 810070871 Pejë.		
Telefoni:	044/529-898	Emaili:	

Për punët ndërtimore në vijim:

Adresa: " Germiza te ura", zona kadastrale Malishevë.		
Zona(t) Malishevë	Nr. i parcelave kadastrale: P-72310047-00856-0, 00857-1, 00857-3	GPS Koordinatat: y- x-

Lloji i ndërtimit të propozuar:

Ndërtim i ri ☒ Rindërtim ☐ Rrënim ☐ Riparim ☐

Kategoria e ndërtimeve të propozuara:

Kategoria I ☐ Kategoria II ☒ Kategoria III ☐

Përdorimi i propozuar:

A përfshin projekti ndryshim të përdorimit? Po ☐ Jo ☐

Shtëpi ☐ Banesë kolektive ☐ Përdorim i përzier ☒
Industrial ☐ Infrastruktura ☐ Tjetër: **Objekt banimi-afarizem B+P+8k**

Përshkrimi: Objekti do të ndërtohet në vendin e quajtur " Germiza te ura ", Gabriati i objektit B+P+8k objekt banimi - afarizem me (dim. 26.4.00x 14.30), sipërfaqja bruto 377.52 m², në parcelen nr. P-72310047-00856-0, 00857-1 dhe 00857-3, zona kadastrale Malishevë, rruga " Ibrahim Mazreku", ana e djathtë afër objektit Lorik Center . Parcela nr. 00856-0 është pronë e Fetah Januz Kryeziu ndërsa parcelat nr. 00857-1 dhe 00857-3 që janë pronë e Njazi, Ali dhe Sejdi Mazreku janë dhënë në bashkë financim me investitorin Agimi Shpk kontrta e noterit nr. LRP. 446/2022 e datës 10.11.2022 dhe pelqimi nga Milit Mazreku për ndërtim të objektit në afërsi të parcelles fqinje 1 meter kontrta e noterit nr. LRP.18601/2022 të datës 02.12.2022.

Vendim

Drejtoria e Urbanizmit e ka shqyrtuar aplikacionin tuaj për leje ndërtimore. Leja lëshohet nën kushtet e mëposhtme:

1. Kjo leje ndërtimore lëshohet në bazë të aplikacionit dhe informatave mbështetëse. Ndërtimi do të bëhet në përputhje me dokumentet e aprovuara ndërtimore. Çfarëdo ndryshimi i projektit duhet të aprovohet nga projektuesi i projektit dhe nga ky Drejtoria e Urbanizmit.
2. Puna në ndërtim duhet të fillojë brenda një (1) viti nga data e aprovimit, përveç nëse zgjatet afati.
3. Duhet të siguroheni se kontraktuesi i posedon në vendndërtim dokumentet e mëposhtme:
 - 1.3.1. Një kopje të kësaj leje ndërtimore.
 - 1.3.2. Nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë, një kopje e kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktorit.
 - 1.3.3. Së paku një kopje të të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent.
 - 1.3.4. Dokumentacioni që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, Kodin, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - 1.3.5. Libri dhe ditari i ndërtimit, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe fotografike, që dokumentojnë:
 - 1.3.5.1. Datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; dhe
 - 1.3.5.2. Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur.
 - 1.3.6. Kartela e aprovimit të inspektimeve, e vendosur në vend të dukshëm. Ruajeni të mos priset nga moti sepse do të ju duhet kur të aplikoni për certifikatë të përdorimit.
4. Duhet të dorëzonin një Njoftim mbi Qëllimin për të Filluar Ndërtimin së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore.
5. Duhet të kontaktonin organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, akte nënligjore dhe Kod. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin ose inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore; dhe
6. Kjo leje lëshohet sipas kushteve të Marrëveshjes për Zhvillim OSE që do të lidhet për sigurimin e infrastrukturës së mëposhtme:.
7. Pas përfundimit të punëve ndërtimore, duhet të aplikoni për certifikatë të përdorimit në pajtim me ligjin, aktet nënligjore dhe Kodin.

D r e j t o r i,

Avdi Morina